



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KATËRTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.04.2022 (e Premte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Anisë Zejnullahu, Reshat Azizi, ndërsa mungoj Taibe Ibrahimimi, Majlinda Shabani, Veton Ramadani. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, përfaqësuesit e KFOR-it.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! duke pas parasysh nga seancat e kaluara kemi miratua disa vendime, ju njoftoj që Zyra Ligjore e MAPL-së na i ka konfirmu ligjshmërinë e shumicës së vendimeve përjashtimisht dy vendime për varrezat në Kabash edhe në Letnicë për këto ende nuk i kemi pranua konfirmimin e ligjshmërisë. Me lejoni të ju uroj edhe festën e Bajramit, sepse jemi në prag të kësaj feste. Tani kalojmë tek pyetjet jashtë rendit të ditës.

znj.Liridona Bislimi: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket pyetjeve dhe ankesave nga qytetarët, dua të shpreh shqetësimin e banorëve nga fshati Drobesh, rreth fabrikës e cila gjendet afër xhamisë së fshatit. Banorët ankohen se gjatë orëve të vona një pjesë e kësaj fabrike po shfrytëzohet për aktivitete ilegale nga të rinjtë e fshatit tonë dhe jo vetëm. Gjithashtu është shqetësuese se ndriçimi publik pikërisht në këtë pjesë nga xhamia e fshatit e deri tek fabrika nuk është fare funksional. Unë i bëj apel Drejtorisë së Inspeksionit si dhe organeve të policisë, që urgjentisht që të ndërmarri hapat e nevojshëm rreth kësaj problematike. Gjatë mandatit të kaluar, disa herë kam ngritur shqetësimin e banorëve të fshatit Mjak. Ata vazhdojnë ta kenë një kërkesë të vetme që rruga kryesore që të qon në këtë fshat të rregullohet. Pyetja ime është kjo: edhe sa kohë duhet që këta banorë të përballen me problemet e udhëtimit derisa komuna të filloj me shtrimin e asfaltit të premtuar tash e ca fushata elektorale me rradh nga kryetari Haliti? Nga disa banorë të fshatit Kabash, kam pranuar ankesa se, në kohën e zgjedhjeve elektorale, kryetari Haliti ka bërë funksionalizimin e ndriçimit në rrugën Shaban Nebi Kabash. Tani pas përfundimit të zgjedhjeve, sipas banorëve ky ndriçim nuk është fare funksional. Pse ka ndodhur kjo, dhe kur pritet të rikthehet ky ndriçim prapë. Në disa nga komunat fqinje, nga Drejtoritë e Arsimit është formuluar një urdhëresë, të cilën janë duke e praktikuar në të gjitha shkollat fillore, ku brenda kësaj urdhërese mes të tjerash thuhet se, ndalohet rreptësisht organizimi i datëlindjeve për fëmijët, personelin arsimor dhe nxënësit brenda

Institucioneve Edukativo Arsimore, si dhe ndalohet rreptësishtë fotografimi-ekspozimi i fytyrave të nxënësve në rrjetet sociale në çfarë do forme. Pyetja është: a keni menduar që një gjë të tillë si DKA ta praktikoni edhe në Komunën e Vitisë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kërkoj që të respektohet rregullorja e punës e Kuvendit Komunal të Vitisë, sepse do të funksionin më mire kuvendit, sepse po behën shume pyetje nga këshilltaret komunal ose ta ndryshojmë rregullore të bëhen më shume pyetje

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! I nderuar nënkryetar, i kam katër pyetje. Sa jemi në respektim të ligjit sa i përket rindërtimit për procedurat e prokurimit publik, duke e ditur se kemi pas probleme në të kaluarën. Ka fjalë se kontratat janë duke u nënshkruar përtej zotimeve financiare. Ne jemi pjese e bashkëqeverisjes, na nuk duhet me dal përtej mjeteve financiare asnjëherë. Unë kam mungu në seancën e kalume, po me sa jam i informuar nuk qëndrojmë mirë me të hyrat vetanake. Tatimi në pronë dhe taksat tjera komunale. Kishim realizu inkasim më të ultë se vitin e kaluar. Sa i perkete riparimit të gropave të asfaltit të prishura, të riparohen mirë, sepse nuk po ngjeshët mirë asfalti ku po harrohet këto. Kërkoj që projektet të jenë më cilësore, Pastrimi i rrugëve, e kemi Ekohigjenën, i kemi punëtorët e Karitasit. Kërkoj që të punohet edhe në rrugët dytësore jo vetëm tek Sheshi deri tek shtëpia e mallrave na kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve, kërkoj prej drejtorin Besnikit, që kontratat mbi vepër që i ki për tremujorin e parë, ti kam në seancën e radhës me emër e mbiemër.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Shfrytëzoj rastin, që në emër të grupit parlamentar të LDK-së të gjithë besimtarëve musliman të ju uroj festen e Fiter Bajramit. Kam dy pyetje, një për drejtoreshën e shëndetësisë. E përgëzoj për iniciativën që e kanë marr në QKMF për vizitat e nxënësve nëpër shkolla: a kanë dinamikë, kur do të përfundojnë këto vizita dhe a janë të përfshira të gjitha shkollat apo në pamundësi i kanë nda. Pyetja e dytë është, tek meremetimet e rrugëve që janë bë: a do të bëhet rregullimi i këtyre rrugëve vetëm në pjesë urbane apo edhe në pjesët rurale.

z.Illir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam një pyetje për drejtorin e Urbanizmit. U kanë muaji i pastrimit, e kemi diskutu edhe në telefon me ju, u jek një deponi e bërllotut në Pozharan e madhe, mirë që u hek po ajo nuk ka pas nevojë mu hek hiq drejtor, sepse u kanë në pronë private, u kanë dashtë që ai personi me e hek e prej Pozharanit deri në Viti janë nja tri deponi të bërllotut. Më mir me i hek këto në rrugën kryesore që shihen si në rrugën Sabit Zuka, te “Lagjeja e Muhagjerve” e ku janë prona publike, pyetja tjetër u kane edhe në media problemi është me qenë endacak në Pozharan. Dje në mbrëmje e kame vizitu familjen që ka pas fëmija i tyre lëndime e mu lut me ndërmarr diçka, edhe për drejtorin e kulturës a ka shpresë këtë vit mu shpall qet subvencionet në rini, sport, kulturë apo me doket doni me e lan për vitin e ardhshëm edhe një krekës për drejtorin e shërbimeve publike. Unë e kam pa dje, kanë qenë e kanë kosit barin në shesh, po në Sheshin e Pozheranit duhet me qenë një mirëmbajtës, sepse është në gjendje shume të ran sheshi.

z.Sokol Shaqiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam një shqetësim lidhur me ndotjen e ambientit, ku po thuajse në shume vendbanime apo fshatra të komunës tonë kemi hedhje të mbeturinave, djegie te mbeturinave, të cilat po e japin një imazh të keq komunës mandej edhe krejt Kosovës, andaj i bej pyetje drejtorit të Inspeksionit se sa gjoha i ka bë kjo drejtori në këtë periudhe të këtij viti që po kalon për t'i ndëshkuar këta ndotës të ambientit me këto veprime të kundërligjshëm, sepse ne në diasporë dëshirojmë ta shohim vendin tone më mirë se ne ku punojmë. Kam një pyetje për nënkryetarin. Tek rruga të varrezat e fshatit Terpezë, a është nda buxhet dhe kur do të fillon, sepse kjo rrugë urgjentisht duhet me ja fillu, sepse kur ka reshje është në gjendje të keqe. Po ashtu edhe rruga tek “Lagjia Bajrami”, pasi që vi nga mërgata e kamë një pyetje për nënkryetarin. Tash fillojnë pushimet verore të mërgatës: a jeni të përgatitur? Sepse vitin e kaluar ka pas mungesë të materialit për letërnjoftime.

z.Musli Neziri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Meqenëse jemi në prag të festes së Fiter Bajramit, më lejoni që të ju uroj të gjithë qytetarëve të besimit Islam këtë festë. Duke respektuar rregulloret e Kuvendit Komunal unë i ngrita dy çështje me interes për qytetarët e Komunës së Vitisë. Kame pyetje për drejtoreshën e Arsimit, po pasi që nuk koka ajo këtu do ta pres ne seancën e radhës. Nënkrjetar, sot do e ngris një shqetësim të banorëve të fshatit Ballancë, pasi ka filluar punimi i trotuarit prej zonës Klllokotit-Zhiti-Ballancë, dhe aty tani është duke u punuar, aty kane fillu të vendosen skajoret rreth rrugës kryesore dhe ato skajore vendosen ne nivel mbi nivelin e asfaltit të rrugës Zhiti. Të jem korrek, rruga është 5 metra dhe I plotëson kushtet për qarkullim në komunikacion, po problem është aty ku fillon rruga e Ballances, deri te shkolla rruga e Ballances nuk I plotëson kushtet që të shtrohet trotuari mbi nivelin e asfaltit dhe shqetësim i banorëve të Ballances është, që trotuari të jet në nivel të njëjtë me asfaltin ose të bëhet si zgjerim rruga aty për arsye se nëse vendosen ashtu nuk bënë sepse bëhet e pakalueshme rruga në komunikacion dy kerre ballë për ballë, prandaj merrne seriozisht këtë nënkryetar, sepse është tu be gabim. Pyetje e dyte e kame për drejtorin e inspeksionit. Nga rruga “Agim Ramadani” në rrugën “Rexhep Bislimi” në Viti, te ura afër stacionit të autobusëve, aty është e vendosur reklama e qendrës tregtare Gorenje dhe është zvogëluar dukshëm dukshmëria në komunikacion nga ana e shoferëve që lehtë mund të ndodhin edhe aksidente. Kjo njëherë është edhe shqetësim i banorëve të lagjeve aty rrethit, kërkoj që të bëhet një zgjidhje me atë reklamë, të i ndërrohet forma ose të zhvendoset që mos pengohet komunikacioni.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam dy pyetje për nënkryetarin, rr. “Hasan Prishtina” është e shtruar në vitin 2019 dhe atëherë kur është shtru ka pas problemet e veta. E kemi diskutu në kuvend, nënkryetari u pat zotu se kemi një marrëveshje me kompaninë punëkryese, e cila do ta rishikon dhe tani është një gjendje që po ka probleme, e ku banoret e penguan punëkryesin, e çka ka ndërmarr komuna në këtë. Dhe pyetja tjetër është kur do të fillon transmetimi i seancave të kuvendit komunal, sepse është obligim ligjor.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! I kam dy pyetje: Ujësjetllësin Trestenik, Sadovinë, Sadovinë e Jerlive, kjo është tepru, po sa nuk ka fillu sezona e thatë me intervenu me herët edhe me lëshu ujësjetllësin. Unë e di që ka problem, ama me se paku le të kanë për ujitje. Pyetja e dytë, operatorët kabllor që janë në Komunën e Vitisë me Kujtesën, Telkos, e lus inspeksioni që le te del në çdo fshat le t'i shoh kablllovikët se qysh janë lidhur për shtyllat elektrike, me pas së paku një estetike.

znj.Vilsona Maliqi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kamë një kërkesë nga qytetarët e fshatit Smirë, për ndriçimin e disa rrugëve, e posaçërisht tek “Rruga e Shkupit”, e cila është shumë e nevojshme, kurse kanë një ankesë, sepse si kërkesë është bë shume here. Unë si anëtare e Komitetit për Komunitete, është mbledhja e tretë që e mbaj pa përkthyes, në seancë e kaluar u be si kërkesë.

znj.Anisa Zejnullahu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Si kur çdo fshat tjetër, edhe fshati Ramjan ka nevojë për investime kapitale nga komuna. Kësaj here kërkesa ime është që të merren në konsideratë nevojat për furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat Ramjan dhe fsh i Ri. Gjithashtu duhet një investim sa më i shpejt në rrugët e arave të shatit Ramjan, në të cilat nuk është investuar asnjëherë deri më tani. Rruga “Emerllahu”, që ka dalje në rrugën Sllatinë e Epërme e ne Pozharan me një gjatësi 750 metra, e cila është e pakalueshme për bujqit e fshatit. Shpresoj që këto kërkesa të realizohen sa me shpejt.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam pyetje për ujësjetllësin për pesë fshatra, është seanca e katër me radhë që e ngris këtë shqetësim, përfshirë Trestenikun, dy Sadovinat dhe dy Sllatinat me tregoni ku është problemi i këtij ujësjetllësi, pse nuk po funksionon deri tani strukturat komunale kanë dhanë përgjigje se mungon tepër e nëse ka atëherë të merren masat të fillohen me procedura dhe të viet deri që ujësjetllësi që të kenë banoret sepse për çdo ditë ka ankesa e nëse është problemi dikune tjetër edhe aty te ndërmerren masa. Pyetja e dytë, rregullimi i trotuarit dhe ndriçimi në fshatin Trestenik, i cili lidh Trestenikin, Sadovinën e Muhagjerve dhe Sllatinen. Me datën 27.10 2021 është lidh kontrata për ndërtimin të trotuarit dhe ndriçim publik, projekt

dvyjeçar me operatoret ekonomik “Pro Grup” dhe Elbao SHPK. Vlera e kësaj kontrate dikun 820 mijë e 153.13 euro, validiteti i kësaj kontrate është prej 27.10.2021 deri me 25.10.2023, raporti financiar i vitit 2021 tek investimet e kryera janë 97 mijë e 496.25 euro kane mbete për tu realizuar edhe 722 mijë 659.88 euro, mirëpo në planin e prokurimit publik për vitin 2022 është parapa të iniciohet një procedurë tjetër e prokurimit, në vlerë prej 350 mijë euro. Përse të realizohet kjo procedurë, kur vetëm se kontrata është e nënshkruar, është valide deri ne vitin 2023. Pyetja është, kur do të filloj implementimi i kësaj kontrate në fshatrat Sllatinë, Sadovinë e Muhagjerve dhe Trestenik per tretuar.

z.Reshat Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë e kame një kërkesë prej banorëve të fshatit Stubell e Ulët dhe Letnic: kur do të fillon ndërtimi i një trotuarit pasi që është rruga e frekuentume, sidomos në muajin e Majit dhe të Gushit një numr i madhe i qytetarëve shtegtojnë deri tek kisha në Letnicë dhe përherë i ekspozohet një rreziku prej komunikacionit. A ka mundësi të filloj të ndërtohet një trotuar për këto dy fshatra.

z.Illir Zuka: Po e shof ftesën për 5 maj, për seancë solemne. A ka të bashkangjitur ndonjë agjendë apo vetëm me një seancë solemne përmbillet 5 Maji?

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Me plan program arsimor ekskursioni i maturanteve është i parapa, prandaj është koha tash që të vendoset apo mos të vendoset për ta dhe dhe po hedhet topi her tek Drejtoria e Arsimit e herë tek Ministria e Arsimit, andaj unë jap një sugjerim që le t'i ndahet përgjegjësia se e kujt është, në këtë rast nga se ka fillu të politizohet rasti.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit: Faleminderit për pyetjet e ngritura për diskutimin, lidhur me seancën e 5 majit ne si kuvendit e kemi per detyre me e organizua seancën solemne pjesën tjetër organizative nuk na takon neve me e organizu. Sa i përket transmetimi te seancave me teleprezencë e bëjmë transmetimin. Nuk jam i kënaqtë me këtë pjesë, kemi bisedu me Zyrën e Informimin edhe me IT-in e kemi bë një projekt që do ta prezantojmë me pjesë të kamerave që do të bëhet transmetim, po edhe kërkoj që të bëhet transmetimi përmes mediave.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ishte pyetja për fabrikën ku u tha që po zhvillohen veprimtari ilegale. Unë konsideroj që në radh të par ajo nuk është pronë e komunës e menaxhon dikush tjetër. Çdo qytetar është obligativ ne aspektin moral ligjor, që kur të sheh asi dukuri ta fton policinë. Ndriçimi jo funksional, drejtori me siguri përgjigjet. Në Kabash u tha që nuk po funksionon ndriçimi, duhet me pa edhe aty lidhur me këtë problem. Inkasimi me i ulet, me siguri drejtori do të përgjigjet po e kemi pas një udhëzim administrativ që e kushtëzon pagesat e qytetarëve, e kanë jek megjithatë edhe tek ne po reflekton ajo negativisht, po megjithatë do ta merrni përgjigjen nga drejtori. Mirëmbajtja e rrugëve dytësore po mundohem me e mbajt të gjitha rrugët, duhet me be përpjekje sa kemi kapacitet që me i mirëmbajt të gjitha. Më ka ardh mirë qe po bëhet vizita në shkolla. Insistoj që asnjë shkollë mos mu përjashtu e për çështje të afateve, me siguri drejtoresha e shëndetësisë e dinë. Unë e përgëzoj diasporën për ambientin dhe e përgëzoj këshilltarin për ngritjen e këtyre problematikave për ndotjen e ambientit. Vitin e kaluar ka pas mungesa në qendrën e regjistrimit, kanë mungu letërnjoftimi e ku kjo është ne domenin e ministrisë. Sa i përket pushtetit lokal, gjithherë do te jemi në koherent me kohen dhe nevojë që e kërkojmë e shtojmë volumin e punës ne pushimet verore. Rruga në fshatin Terpezë është në projekt, e di që është tu punu, e di qe është e projektume edhe rruga ne lagjen Bajrami, po a është për këtë vit nuk e di. Këshilltari Neziri, Ballancë trotuari. Unë besoj që janë tu punu në bazë standardeve. Sa i përket nivelit te asfaltit, automatikisht shkakton rrezikshmërinë e qytetarëve, ndërsa për zgjerim të asfaltit, kryetari në bashkëpunim me ingjinerat e ka thanë, ndërsa ngritja e trotuarit është standard. Plotësisht jam për zgjerim, por jo edhe sa të ketë rrezikshmëri. Ata te cilët e kane vendos reklamën e Gorenjes e kanë pas parasysh edhe atë, nuk ka kontrate cilën e lidhem e qe nuk e ka garancionin e qëndrimit sa janë tu përmbush ato. Insistoj mu përmbush, është problematike me i përcjellë nëse nuk përcjellët edhe nga ana e mbikëqyrësve, nuk ka

kontratë që guxon të lidhet dhe të nënshkruhet pa e pas edhe gradacionin. Për çështjen e transmetimit të seancave, kam menduar se kuvendi dhe pjesa tjetër duhet të shikojmë atë edhe në aspektin ligjor e plotëson por çdo sen që është ma transparente mu nuk më pengon, ujësjellësi për pesë fshatra, se shumë herë janë përsëritur të njëjtat, dy këshilltar të cilët e ngritët. Ju jeni ndal me një problem, se shumë lehtë mundeni me zgjidh. Ju kam thanë edhe këtyre, por duhet me qenë parimore, nuk menaxhohet nga “Hidromorava”, rrymën e keni ju, shumë ma pak ka pas pagesë të rrymës se sa kur keni menaxhim të “Hidramoraves”. Me i pas ndëgjju, sot e kishi ujin dhe uji do të jet ma cilësues se sa funksionon, është edhe ramja, por nuk e keni bërë. Ai atje po thotë se nuk e kem hargju dhe unë çdo ditë presion. Nuk kam fjalor tjetër, i vetmi variant është me prit ose me shpall CDI-n dhe përfaqësuesit e CDI-së, që unë e kam thënë, po e tregoj të drejtën, çështja po lidhem të e Nexhatit, pasi që ishte pyetja e njëjtë ku ishte rregullimi i trotuareve. Ti the vet se dhe pyetja kur thae kur do të fillon, veç ia paska fillu në Ballancë, tash gradualisht e përmbylim edhe këtë çështje. Këshilltarët të cilët mandatin e parë i përgëzoj për çështjet të cilat i kane ngrit edhe çështjen e ndriçimit të rrugës së Shkupit. Unë konsideroj se po shkojmë gradualisht, këtë vit jem tu bë përpjekje me mujt me shndërru në alternativë tjetër. Kryetari ka dhënë si detyrë, se atje është thënë se sa e paguajnë këstin mujor të shndërrojme formë tjetër, që mos shpenzohet energjia që me të vërtet mos ti behet barr komunës. Unë besoj se kem me pas parasysh edhe ne, edhe nëse është domosdoshmëri, pse mos me bërë. Çështjen edhe për komitete ke me zgjidhe të përkthyesit, nuk ka me pas problem. Me ujë të pijshëm, këshilltare jo veç Ramjani po përgjithësi jem keq në Komunën e Vitisë, jem tu bërë përpjekje me dal prej kësaj situatë. Gjatë përfundimit të këtij mandati, sot si nënkryetar i komunës pa asnjë projekt tjetër veç t’i mirëmbajmë këto. Tjerat, këto që i kem ujin e pijshëm ta siguroj, nuk është çështje e lehtë për shkak se bindu kur të shkojmë në kuadër të ministrisë, unë kam qenë një dy tre takime me siguri edhe juve si mandat i ri i kuvendit ka mi mbledh një dy këshilltar në kuadër këshillit ndërministror. Unë i tregoj realitetin ata me tregojnë tjetër, Komuna e Vitisë me gypa të paraqitura 80%, gypa kem sa dush ujë të pijshëm nuk kem se ata raportojnë qysh i ka raportu CDI-ja , edhe në Smirë ka gypa ama ujë nuk ka, dhe në Verban ka ama ujë nuk ka, dhe prandaj unë konsideroj se me ujë janë plotësua nevojat. Krejt këto tjera janë pune shumë mat mëdhaja kur në rast se qytetari se shijon dhe nuk i kryen obligimet e veta nuk i përmbush me ujë, investim në rrugë. Unë konsideroj se kem bo shumë ceshtje me siguri ka nevoj e perjashtoj edhe Ramjanin e din se shumë projekte janë krye në Ramjan dhe keshilli i fshatit i ka dhen prioritet diqka tjetër gradualisht kalohet , Reshat ,Stubell Letnice kerkush nuk e perjashton munsin se met vertet ka levizje në vecanti ngusht ,ceshtja e trotuarit rruga Letnice ka karakter tjetër nga kjo për Stubell,si ceshtje me ngrit të ardhmen me parapa ben për shkak të cilat ndërtime kerkohen me përpara , Remzi nese eskursionit eshte parapam duhet të realizohet dhe unë besoj me se miri e njëj ju perfoesor ,eskursionit e din se gjithëher e ka për qëllim ngritjen edhe të nxensve, jam për një zgjidhje dhe për një ngjitje dhe të cilat dhe eskursionit në form të konforme legjislatura në konforme normave pedagogjike të cilat ti i din me mire , tu ju njoftoj se edhe ato zotimet para se me hi në rend të ditës të cilat unë i kam për prioritet për politik dhe financa ja kom pregadite si jemi marr vesh.

Drejtor z.Basri Aliu: Përshëndetje për nënkryetarin, asamblistët, për bordin e drejtorëve dhe për të gjithë pranishmit që janë në sallë! Do të mundohem shqetesimet që i kane ngrit këshilltarët t’iu jap përgjegjje , fillojmë me Liridonën e cila e paraqiti si shqetesim ndriçimin të fabrika kisha pyete a e ka pyetjen për rrugën kryesore apo naj rrugë tjetër , është fjala për rrugën kryesore që të qon për rreth e kalon fabriken është një rrugë ku lidhet këto tri objekte kryesore ndriçimi publikë nuk është funksional tash që një kohë të gjatë , do të marr këto dhe të intervenojë sigurisht masi veq ket informat nuk e kam pas ,ke fjala edhe për një rrugë tjetër për fshat Kabash është dhe një pyetje tjetër rreth meremetimit të rrugëve të cilat po behen kjo ke nga Taulanti dhe Alia që a dot hyne edhe rrugët rurale na nuk e kemi të percaktume se cilat rrugë aty ku kemi nevoj dot intervenojmë dhe ti reparojmë cdo cep të territorit komunes së Vitise , Iliri e pat një pyetje me mirëmbajtjen e sheshit në Pozharan të shofim

mundesit qysh jane po shpresoj se une duhet mi bo mundesit na e kem nje ekip per mirmbajtjen do ta percaktojm dhe nje person te vecant si profozim do ta shqyrtojm.

Drejtori, z.Adnan Imeri: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit! Për drejtorin e inspektionit u parashtrun disa petyje te cilat jane te rendesishme pyetja e pare nga asambleisti Ilir Zuka qe ka te beje me trajtimin e qenve endacak, Ilir komuna e Vitise e ka nje marrveshje te nenshkruar per trajtimin e qenve endacak qe nuk e kan dot thote te gjitha komunat dhe menagjer i kesaj marrveshje ,menagjer mbikqyterse eshte inspektori i ambientit Afrim Sylejmani aksioni per trajtimin endacak e kem fillu me daten 10 shkurt te vitit 2022 dhe gjate gjithe kesaj kohe jane trajtu dot thote nje numer i madhe i qenve endacak, dikun 139 qene endacak jane zen dhe te njejtj jane trajtu ne forma te ndryshme shembull e kem 111 jane trajtuar me kastrim ,sterilizim dhe vaksinim te njejtj mbas sherimit jane leshuar pastaj e kem edhe nje numer tjeter shembull prej 28 qene te pa sheruar dhe te njejtj jane tajtuar dhe kemi numrin prej 6 qene te cilet jane hase te ngordhur dhe ata i kemi marr dhe i ke kemi vorrosur , pyetja tjter eshte prej asambleistit Sokol Shaqirit ispektort e drejtoris te ispektionit gjate gjith kohes gjithe se bashku pa dallime sektori jem aktiv me parandalimin e kesaj dukurie negative psh deponive dhe hudhjes se mbeturinave edhe pse e kemi pas ket aksionin me drejtorin e sherbimeve publike dhe drejtorin e urbanizmit per ruajtjen e ambientit gjate gjithe kesaj kohe kem shqiptu gjoba te ndryshme dhe i kem detyru ata te cilet kan hudhe mbeturina te anatarsohen me ekohigjien me qellim qe ne te ardhmen mos te hudhen mbeturina vetem ne muajin Prill kemi mbi 10 shqiptimeve te gjobave mendatore ,per informacione mat detajume ftojme dretorin e inspektionit ti shiqojm te gjitha aktivitetet te cilat i kemi ber.

Drejtor, z.Visar Demiri: Përshëndetje për të gjithë! Lidhur me pyetjen e keshilltarit Ilir Zukës, gjate diteve te ambientit kemi hek nje numer te caktuar te deponive ilegale nje nder to ka qen edhe kjo deponia qe u permend ne Pozharan e cila besoj se ka qen deponia me e madhe ilegale ne komunen e Vitise ,hapsira te cilat se pjesa me e madhe ka qen hapësire publike nje pjes me e vogel eshte rritur gjate lumit , per sa i perket deponive tjera te cilet jane numer te madhe ne komunen e Vities deponive ilegale ,aktiviteti nuk ka perfundu me 22 prill ne vazhdojm gjithashtu kur e shohim mundesin e marrim ndonje donacioni per te hequr te gjitha deponit ilegale.

Drejtoresha, znj.Merrushe Ahmeti: Përshëndetje nënkryetar, kryesues, ju drejtorë dhe përfaqësuesit e KFOR-it! Atëherë zotri Aliu met falenderu per pyetjen dhe per kujdesin ndaj nxensve ndersa sa i perket ceshtjes per vizita sistematike te nexensit ku eshte e parapame qe te vlersohen 30 parametra duke perfshi edhe shendetin oral te nxensve parashihet te behet deri me daten 5 Qershor po ashtu jane te perfshira gjitha shkollat e komunes se Vitise e cila ka per qellim parandalimin percjelljen dhe kontrollen e shendetit tek nxensit .

Drejtori, z.Valmir Sahiti: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, bordi i drejtorëve, këshilltarë komunal! Me lejoni qe te adresohem shqetesimit te juaj rreth subevencionve te drejtoris per kultur rini dhe sport me lejo qe te njoftoj qe komisioni eshte fermu dhe ne fazen perfundimtare te vleresimit , po ashtu para jush ta shpalos qendrimin e qeverisjes lokale me iniciativen e kryetarit te komunes dhe aprovimin e bordit te drejtorve te gjitha organizatat joqeveritare ne komunen e Vitise te cilet kan aplikuar ne fushen e kultures rini dhe sport e qe i plotson kriteret ket vit do te subevencionhen ,ket vite dot te ket prej propozimeve do te kalojn ne shum filtra dot jet komisioni per vlersim dot jet komisioni per ankesa dhe ne fund komisioni i cili dot bej monitorimin e projektve prandaj une jam i bindur qe komisioni ka me ber punen ne menyren sa me mir dhe menyren sa me profesionale te mundeshme duket realizuar ne transparence te plot dhe nje gjithperfshirje prandaj edhe vendimet dhe procesi bespj se dot perfundoj mbrenda pak ditesh po ashtu me lejoni qe te jap nje sqarim rreth ceshtjes se agjendes se 5 Majit te cilen e ngrite do te ket agjende me daten 4 Maj ora 11 ktu ne sallen e kuvendit komunal dot behet promovimi i veprave te Nusret Pllanes me lejoni qe ti ftoj te gjith antaret e kuvendit komunal per pejsmarrje po ashtu prej ores 14:00 dot ket aktivite te ndryshme sportive dhe me daten 5 Maj dot jet seanca solemne dhe homazhet te varrezat e deshmorve.

z.Taulat Haxhiu: Zotëri Aliu, te investimet kapitale nuk guxon te tejkalohet zotime financiare por ndodhi nuk eshte e mir po ndodhin krejt qytetet e kosoves po na duhet me ber perpjekje mos me ndodh ne Viti , te pastrimet e rrugve une mengjes zakonisht kur po pi kafe aty te parku po shohum puntor te ekohigjienes ata me mujt me bo punen per cka kane ardhë qyteti i Vities behet me i paster se qyteti i Zvicrres , jo vetem te sheshi po te punojn edhe ne ane tjera fatmirsisht une jam nga vitia jam qytetar i Vitise dhe e di se ne do rruge dytesore nuk eshte pastru , e ka per te miren e qytetarve ,te asfaltimin kerkova qe te behet ma cilsore per te vetmen arsye qe te njeften rruge mos ta harrnojn cdo 6 muje ose 1 vjete po te ket cilesi qe spaku nje mandat mos te shohum ne rrugen e njejt , drejtor te tatimet, inkasimet te tatimit ne prone dhe taksave tjera eshte mir qe ma shum te keni inkasime jo te keni regres.

z.Musli Neziri: Faleminderit nënkryetar qe me dha pergjigjie. Unë po du me i tregu nenkryetarit nese nuk eshte ne dije hiq se ja paska fillu ne Ballance qe spaku ta shohum mu kriju bindja qe nuk je ne ngjarje qe nuk ja ka fillu ,trotuari ne fsh Ballance mos flasim per standard te qohum prej ktu te shkojm hypim ne makina dhe provojm me dal une e ti perballe nese kalojm une terhekna dhe kerkoj falje , prandaj jo standarde nuk japim pergjigjie standarde sido aty behet rruga e pa kalushme nese vazhdohet me standarde te trotuarit qysh ka fillu ne Zhiti kjo eshte shqetesimi i banorve ne fsh Ballance , ne fsh Zhiti eshte ne rregull trotuari tu shku nese vazhdon ne fsh Ballance rruga behet e pa kalushme dhe nese eshte e kunderta prandaj eshte shqetesim serioz.

z.Nexhat Halili: Unë po du mu nderlidhe edhe nje here te ceshtja e ujesjellsit a eshte qasja e rrymës. Nese eshte ceshtja e rrymes ateher mirret nje iniciativ dhe te zgjedhim ket problem , per drejtorin e financave ne raportin te vitit te kalum ne raport 97mij euro investime por nuk ceket per cilat lokalitete jane kry kto investime , te drejtori i sherbimve publike rreth ndriqimit , ne ora 05:00h ndrqiimi publik funksionon eshte heret 3 ore deri ne ora 08:00h mos mi shpenzu , ndoshta kjo rryma e ujesjellsit lidhet edhe me ndriqim publik.

z.Illir Zuka: Drejtor Basri, puntori ka qen aty ka punu aty shum mir , e ka mbajt edhe shatorrin Mejdi Korrani edhe sheshin ne Pozheran , po fatekqesisht puntori ka vdek ne seance kam kerku me zevendesu mos me len sheshin ne ate gjendje .

z.Reshat Azizi: Për çështjen e trotuarit Stubell Letnice, nenkryetar shumica e rruges Viti-Letnice eshte e rregullume me trotuar spaku deri ne fsh Ramanisht ajo pjesa tjeter eshte territor i tjetres komune aty ne skem kompeteca me u perzi por e kerkova prej Stublles-Perlepnice ku eshte rruga ma e rrezikshmja spaku prej rrafshit aty ku lidhet rruga e Stublles –Perlepnice spaku prej aty te rregullohet nje trotuar se kjo pjesa tjeter me sa e di une deri ne Ramnisht eshte e rregullume.

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, një pyetje nuk mu përgjigje rruga “Hasan Prishtina”por dashta me u lidhe pak por jam shef i grupit parlamentare te puna e ujesjellsit vitin e kalum na dhe gjith komuna e Vitise ka qen te pakten e fushte me uje te pijshem ne shtepi keshtu keni deklaruar ne emisione ,edhe ne mbledhje dhe ne KPF se ne vitin 2021 do te funksionalizohen 14 vendbanime me ujesjellse , ndersa edhe 8 vendbanime te tjera ne 2022 me marrvjeshten me CDI-n tash po jane krejt tjera probleme,ndersa ne vitin 2020 ne partin e buxhetit kur se kem votu na e kemi pas brengen mee te madhe telashet mat madhe apo kundershhtimin me te madhe se ne 2021 jane parapa vetem 30 mi euro per filtrim dhe rregullim te ujit ne Letnice ndersa tjerat si keni parapa nuk kane qen te parapame dy vitet pasuese 2022 dhe 2023 vitin e kalum e di qe eshte dikun 230mi euro i keni shtu , dashta me thane se muk ka qen prioritet uji i pijes flasim me dokument.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Taulant, asnjë çështje te cilin e ngrite nuk kem pas ti veq i perserite kto une ashtu i dhash pergjigjiet ,per mu eshte prioritet edhe rruga kryesore dhe dytesore dhe ceshtje tjeter te zyres prokurimit e perserite te njeften ajo eshte e thirrur me respektu ligjin e kem shkallshmerin ne shkallen e dyte cdo operator ekonomik qe konsideron se eshte shkel procedura ligjore ankohet dhe e kthen ,tjeter zotri Neziri te thash se nen ekzekutiv kem then se duhet me zgjeru per ndryshe nuk jem te interesum me qen jo

funksional ti vet me the se ka fillu trotuari eshte tu vazhdu kerkove zgjerim apo nevelizim me asfaltim nese nk behet zgjerimi i rruges kshtu ke pyetja,ke kerku prej ekzekutivit zgjerim te thash keshtu per ndryshe per ndriqim nuk kem kerku nevelizim duhet te kem te kjart ,ceshtjet te cilen Nexhat qysh i ke ber pytjet i ke pergjigjiet po e perseris mos marrja ne menagjim nga ana e hidromoraves eshte ndalesa e ujit kam then eshte mos pagesa e rrymes qe se keni pagu dhe prandaj nese ti don mu sjell veq kesaj se ski ide tjetet si keshilltar i kuvendit komunal per pergjigjia eshte kjo,zotri Jakupi asnje nuk eshte kjo qe po i thu nuk eshte qe nuk qendron veq se po i lidhe me politik po gabon , kem then se 14 fshatera eshte marrveshje te cilin e keni miratu edhe eshte ardhe ket kuvend ju keni gzu edhe ju por nese thu me bo luft me CDI-n dhe me ministrin ,prandaj nuk po them se eshte politike na me vullnet e kem nenshku , paret kan qen te gatshme se kane ber une i pranoj kritikate kur thu asfalti i dopt se jam kan drejtperdrejt , por mem than pse nuk e ke realizu ket marrveshje une e kam pas per obligim paret jane kan te gatshme edhe sot veq ne te realizojn spo e realizojn kjo eshte prandaj nuk po du me ja dhen at qe po thu qe e kemi pas per fushat nuk e kam per fushat nuk me ben pershtypje as funksioni kur eshte ceshtje te cilen jane te ndishme per qytetaret , nuk eshte me rensi ku gjinden ose cka gjinden dhe cka paraqiten po konsideroj se jam te kry ni mision timin jetsor qe e kam obligim ndaj vendit tim,jam ne gjendje ndaq mu sakrifiku jo me then e keni pas per politik ,me bindje te plot e kemi then se ekzekutore kane qen ata detyre e jona eshte kane permes kuvendit ju qe keni qen me ja paraqit dhe ju me ma dhen miratimin ,por ata se kane kry e tash me lyp pergjegjesi prej juve , ato pare nuk jane as te mijat as kryetarit as juve jane gjithje prandaj interesimi jone ka qen eshte edhe sot gjendja eshte kjo tash sa kemi mundur me qellu sa kemi munder ket mekanizem a kena pas forc ma shum krejt kto duhet mi pas parasysh ,edhe pse angazhimi jone ka qen superlativ.

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, për mu u kanë e ditun se kjo nuk realizohet te kam then edhe ateher edhe sot , tash a e lidhi me politik a si lidhi me politik nuk e di se si tingllon se nuk e kam shfrytezu per politik e di se njerin prej mbledhjes te KPF-se kam then se kjo nuk behet , sodomos vitin e kalum kan qen kontratat mbiveper dhe te ndryshme ne operatura te mesme keto kane qen prioritet uji i pijshem nuk ka qen prioritet kjo eshte fatekeqesi qe e kemi sot bashk e di se ka munges gjithqka , munges edhe te ujit ne Letnice kto politika i ka ber tjetet kush jo ti.

z.Nexhat Halili: Nënkryetar, secilën seancë e ki potencua çështjen e rrymës. Të ftoj te vish ti vizitojsh kto 5 fshatera dhe nese eshte ceshtja e rrymes te bejm nje zgjidhje dhe ujesjellesi nuk funksionon sa i perket reklamimit nenkryetar nuk ka nevoj me u reklamu edhe nese rreth ceshtjes ujesjellsit.

z.Drejtor Basri Aliu: Taulant, punëtorët qe i sheh ne mengjes eshte mir qe i sheh po edhe po e mbajn pastertin shum mir , edhe po te vjen qe sheshi eshte mir edhe Vitia eshte nje nder qytetet me ta pasterta , dmth i kan edhe trotuaret ne fshatera kane me shku edhe ne vende ne hapsira publike edhe ne pjesen tone edhe une jam i Vitis nashta ma shum se sa ti , kshtu qe e dim Vitin a ka nevoj me intervenu hala gjithsesi ka nevoje cdo her ka me pas nevoje , kshtu qe ne duhet mu permisu ket drejtim a eshte mu intervenu edhe ne pjes tjera gjithsesi qe po.

z.Taulant Haxhiu: I nderuari Aliu, po me vjen mir se ti mundesh mem tregu per Viti se je Vitias por une po e shoh nje rruge dytesore shembull te sheshi te rruga xhamise ne rrugen “Hasan Prishtina” ku jetoj une ka nevoj , une e shfaq si informatik nevojen qe mundemi me shum me dhen pune njerzve te cilet e kan nje kontrate qe ata me punu ma shum qe qytetti jon mu kan me i pastert ,tash tjeret qe nuk kane pas mundesi me um kuptu ose kam kuptu me nje intuit politike ateher skam cka beje.

z.Illir Zuka: Drejtori duhet me u pergjigj. E kem ndertu nje shesh jashtzakonisht te mir Pozheran e kemi nje shtatore duhet mu kan nje mirmbajtes ka qen ka vdek duhet mu zevendesu besoj se prej te Henes duhet me fillu punen ne shesh ne Pozheran nje puntor i ri.

z.Drejtor Basri Aliu: Punëtori u caktu prej menagjerit qe ka qen , po tash te shofim a u plotesu krejt ne rregull jam tu kuptu ne ate pune te shofim mundesit spo te tham gjithesesi se nese mbas nje muje shihum apet kshtu qe ma mir e lejme sa kem mundesi eshte edhe ne interes tone per mirmbajtjen

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë seancë kemi parapa këtë rend dite:

R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a tretë e rregullt e KK-së.**
2. **Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2022.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022.**
Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në Zonën Kadastrale në Sllatinë.
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme të komunës në shfrytëzim**
7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Ambulantës në fshatin Gushicë në Viti.**
8. **Informatë për manifestimi tradicional kulturo-sportiv “Flakadani i Karadakut 2022”.**

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a tretë e rregullt e KK-së

z.Jakup Demiri: Unë e kam për te procesverbali te faqja e parë ku thote ne mbledhjen moren pjese kryesuesi i kuvendit , kryetari Sokol Haliti qe kto une nuk e shoh se kryetari ndoshta vjen dikur me vone kur te kryhet seanca i shkruhet emri ktu dhe kjo nuk eshte ne rregull kisha kerku te rregullohet te shkruhet se ne pjesen e fundit iu bashkangjiti ne fare ne fund se nuk eshte reale kjo cka shkruhet ktu per at e kam si shqetesim se nuk e kemi kryetarin ktu ndashta me vone vjen edhe ne seancen tjeter kemi pas ne procesverbal ku shkrun se moren pjese edhe kryetari.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këtë shqetësim unë kam bisedu me Fatlumin edhe me heret mirpo na kemi raste qe kemi keshilltare qe vjen rrin gjys ore nje ore edhe hece , tash aj nuk eshte shumicen prezence seances por aj momentin qe u kane ose ka ardh ne fund seances aj e merr edhe meditetjen edhe nenshkrun edhe aj eshte prezent dmth ne baze te rregullores te Kuvendit per ate arsye edhe une kam diskutu mirpo per momentin qe k ardh me nje pike te rendit dites ka qen ateher tregon se ka qen prezent fizike kjo eshte kan pergjigjia qe kam marr nga ana ligjore , se nese ki marr pjes me nje pjes te seances ki marr pjes fizikisht ateher shenohet prezenca ne seance.

z.Ali Bajrami: Veç është mirë me sqaru. Në moment qe ka qenë prezent apo eshte i regjistrum ne regjister si pjesëmarrës, qe nuk ka qen prezent veç këtë ta sqarojmë.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Nëse ka lidhje me procesin e për vërejtje për shkrimin mundeni me marr fjalën për pjesën tjetër eshte pjesa teknike e zyrtarve qe e kan anen ligjore qe do ta respketojn, Pasi që nuk ka të tjer për diskutim kush eshte per miratim te procesverbalit. 0 kunder, 4 apstenim, 17 vota pro miratohet procesverbali.

Si pikë të dyte të rendit të ditës kemi:

2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën Janar-Mars 2022

